347/6

REPUBLIKA E SHQIPERISE
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**Nr. 347/6 ---Vendimi**

## VENDIM
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 12 01.2006 une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane A. Caco, pasi shqyrtava kerkesen e kerkueseve z. Isa Kreka dhe z. Bashkim Kreka te cilet kerkojne:

Regjistrimin si person juridik te shoqerise mediatike "DARDANI" shpk me objekt te vetem veprimtari radiotelevizive lokale.

## KONSTATOVA

Ne baze te Statutit dhe Kontrates se Themelimit eshte themeluar Shoqeria Mediatike me Pergjegjesi te Kufizuar "DARDANI" shpk si vazhdim i veprimtarise televizive TV DARDAN , me seli ne qytetitn e Elbasanit, rruga 11 Nentori, lagjia Qemal Stafa, me ortake themelues z. Isa Kreka dhe z.Bashkim Kreka dhe administrator te shoqerise z. Isa Kreka, me kapital themeltar 500.000 (peseqinmije ) leke te derdhur prane arkes se shoqerise nga ortaket z. Isa Kreka 60% e barabarte me shumen 300.000 (treqindmije) leke dhe z. Bashkim Kreka 40% e barabarte me shumen 200.000 leke (dyqindmije) leke . Kundervlefta ne EURO eshte depozituar ne Banken Popullore Dega Elbasan ne numer llogarie 00021815. Kohezgjatja e shoqerise e pacaktuar mbi 20 vjet.
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Veprimtaria radiotelevizive (lokale) perfshi prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikim nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte te organizoje, regjistroje spektakle te bukurise, spektakle te modeleve, prodhimin e dokumentareve televiziv, filmave televiziv. Ka te drejte shitjen dhe tregtimin e pasurive te saj te prodhimeve audio dhe vidio si dhe prodhimeve te te tjereve kur eshte i autorizuar.

Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte importimin e paisjeve teknike qe i sherbejne prodhimit dhe transmetimit te figures dhe zerit si dhe tregtimin e tyre.
Pas shqyrtimit te materialeve te paraqitura cmoj se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuara ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## PERKETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare", ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin e Shoqerive Tregtare" dhe ligjit Nr. 8410 date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise"

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses
Regjistrimin si person juridik te shoqerise mediatike me pergjegjesi te kufizuar "DARDANI" shpk me seli ne Elbasan, rruga 11 Nentori, Lagjia "Qemal Stafa", me kapital themeltar 500.000 leke te derdhur nga ortaket ne raport 60% me 40% , me kohezgjatje te pacaktuar mbi 20 vjet dhe objekt veprimtaria radiotelevizive (lokale) perfshi prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikim nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte te organizoje, regjistroje spektakle te bukurise, spektakle te modeleve, prodhimin e dokumentareve televiziv, filmave televiziv. Ka te drejte shitjen dhe tregtimin e pasurive te saj te prodhimeve audio dhe vidio si dhe prodhimeve te te tjereve kur eshte i autorizuar.
Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte importimin e paisjeve teknike qe i sherbejne prodhimit dhe transmetimit te figures dhe zerit si dhe tregtimin e tyre.

Kunder ketij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE

Ariana Ceço

**KONTRATA E THEMELIMIT**
**TE SHOQERISE MEDIATIKE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"DARDANI" SHPK**

Sot me date 14.dhjetor 2005 ne te poshteshenuarit e kesaj kontrate vendosem krijimin e shoqerise mediatike me pergjegjesi te kufizuar "DARDANI" shpk vazhdim i veprimtarise televizive te TV DARDAN Elbasan.

***1- Isa Kreka, i biri i Qazimit datlindja 05.06.19951, lindur ne Gjakove, Kosove dhe banues ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia Luigj Gurakuqi, madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr.1601364***

***2- Bashkim Kreka, i biri i Qazimit, datlindja 29.07.1971, lindur ne Elbasan, banues ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia Luigj Gurakuqi, madhor, me zotesi te plote juridikeper te vepruar, me pasaporte*** nr.Z1441676

Nga ana jone lidhet kjo kontrate me kushtet si me poshte:

## NENI 1

Personat e siperpermendur, me vullnetin e tyre te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar, rane dakort qe te krijojne shoqerine mediatike me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "DARDANI" SHPK dhe me kapital themeltar 500.000 leke.

Kjo shoqeri e ka qendrern ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia "Qemal Stafa" dhe do te njihet me emrin "DARDANI" shpk.

Ortake te kesaj shoqerie, pronare te pasurive te vena ne dispozicion te saj sipas kontributeve jane Isa Kreka dhe Bashkim Kreka. Administrator i shoqerise eshte z. Isa Kreka.

Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte te krijoje filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovim te organeve kopetente.

## NENI 2

Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkengjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

## NENI 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kopetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi 20 vjet.

Shoqeria e mbaron aktivitetitn e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate , nese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjatin kete afat.

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, nese per kete marrin vendim unanim te gjithe ortaket e qe bejne pjese ne kete shoqeri.

## NENI 4

**Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk do te kete si objekt:**
Veprimtari radiotelevizive (lokale) , dhe rajonale ( me daljen e ligjit) dhe perfshin ne objekt prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit,figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikim nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.

Ne objektin e saj perfshihet gjithashtu organizimi i spektakleve te bukurise, modeleve,dhe regjistrimi i tyre audio dhe viziv, prodhimi i spoteve , reklamave, dokumentareve televiziv dhe i filmave televiziv.

Shoqeria ka te drejte te importoj nga jashte vendit pajisje audio dhe vizive si dhe teknike ne sherbim te aktivitetit te shoqerive mediatike si dhe tregtimin e tyre.

## NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise mediatike "DARDANI" shpk perbehet ne te holla ne nje vlere prej 500.000 leke
Ky kapital themelor zoterohet nga ortaket ne kete menyre:

**1 . Isa Kreka zoteron 60% te kapitalit themeltar dhe depoziton prane arkes se shoqerise shumen prej 300.000 lekesh.**

**2 . Bashkim Kreka zoteron 40% te kapitalit themeltar dhe depoziton ne arken e shoqerise shumen prej 200.000 lekesh.**

## NENI 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie do te ndahet ne proporcion me kapitalin e tyre ne kete shoqeri.

## NENI 7

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

## NENI 8

Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortak nje person i trete pa pelqimin unanim te ortakeve.
Nuk mund te hiqet dore nga kjo kontrate ne menyre te njeanshme pa pelqimin e ortakeve te tjere. Ortaku qe deshiron te shese pjesen e tij ne kete shoqeri eshte i detyruar qe oferten e tij per shitje t'ia beje ortakeve te tjere dhe nese keta te fundit nuk pranojne te blejne ose nuk japin pergjigje brenda 30 diteve nga dita e berjes se ofertes, atehere ortaku kete pasuri mund tia shesi vetem personave te tjere te familjes, ose te heqe

dore nga shoqeria duke marre pjesen e tij te investuar plus fitimin , kjo e shoqeruar me bilanc.

## NENI 9

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin konfidencial te aktivitetit te shoqerise.
Ortaku qe shkel detyrimin e mesiperm dhe nga kjo shkelje shoqerise i shkaktohet nje dem, eshte i detyruar te shlyej demin.

## NENI 10

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

## NENI 11

Konfliktet qe lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen me marreveshje midis tyre. Ne qofte se ortaket nuk merren vesh per zgjidhjen e konflikteve me mirekuptim, kopetente per zgjidhjen e ketyre konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan.

## NENI 12

Ortaket kane te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve:

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te kerkojne dhe t'u jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (bilanci,libra llogarie).
- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblese se Shoqerise. Administrator i dhoqerise eshte z. Isa Kreka.
- Te heqin dore nga shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne kete kontrate dhe ne statutin e saj.

## NENI 13

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.
Ortaket pasi lexuan me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjeten konform vullnetit te tyre, me vullnetin e tyre te lire e firmosen ate.

## ORTAKET

**ISA KREKA** — Isa Kreka

**BASHKIM KREKA** — Bashkim Kreka

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA TIRANE**
**NR 1578 Rep**
**NR 3/13 Kol**

## VERTETIM

Sot me date 14.12.2005 (dymije e pese) ne zyren e noterise ne Tirane me adrese rruga "Puntoret e Rilindjes" para meje noter Asim Zeka u paraqiten personalisht kerkuesit:

1- ***Isa Kreka i biri i Qazimit, lindur me date 05.06.1951 ne Gjakove, Kosove dhe banues ne Elbasan, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr. 1601364.***
2- ***Bashkim Kreka, i biri i Qazimit, lindur me date 29.07.1971 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaport nr. Z1441676.***

Te siperpermendurit me deklaruan se Kontraten e mesiperm te themelimit te shoqerise mediatike " DARDANI " shpk e kane bere me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe e nenshkruan para meje noterit Asim Zeka dhe une e vertetoj sipas ligjit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE — ASIM M. ZEKA — NOTER — TIRANE

**Noteri**
**Asim Zeka**

# STATUT

## I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DARDANI" SHPK

## KREU I

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 1

Ne perputhje me ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", si dhe ligjit 7667, date 28.o1.1993 "Per regjistrin tregtar" e formalitetet qe duhen plotesuar ne te: ligji 8410, date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise" formohet me vullnetin e tyre te lire shoqeria tregtare mediatike me pergjegjesi te kufizuar "DARDANI" SHPK, si vazhdim i veprimtarise se TV Dardan.

Kjo shoqeri krijohet nga ortaket:

*1-Isa Kreka, i biri i Qazimit datlindja 05.06.19951, lindur ne Gjakove, Kosove dhe banues ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia Luigj Gurakuqi, madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr.1601364*

*2-Bashkim Kreka, i biri i Qazimit, datlindja 29.07.1971, lindur ne Elbasan, banues ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia Luigj Gurakuqi, madhor, me zotesi te plote juridikeper te vepruar, me pasaporte nr.Z1441676*

Shoqeria e ka seline ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia "Qemal Stafa" dhe do te njihet me emrin "DARDANI" shpk.

Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte te cele filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me legjislacionin e atyre vendeve ku mund te hapen keto filjale.

Administratori i shoqerise eshte z. Isa Kreka.

## NENI 2

Shoqeria mediatike “DARDANI” shpk e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te shtetit Shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te kesaj shoqerie (kontrates se themelimit dhe ketij statuti).

Shoqeria mediatike “DARDANI” shpk eshte person juridik. Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e marjes se vendimit nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane dhe regjistrimi ne Regjistrin Tregtare.

## NENI 3

Shoqeria mediatike “DARDANI” shpk krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje mbi 20 vjet.

Shoqeria mediatike “DARDANI” shpk mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose mund ta mbylle aktivitetin e saj para ketij afati, sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kritereve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

## NENI 4

Shoqeria mediatike “DARDANI” shpk per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet, pergjigjet vetem me pasurine e saj. Ortaket e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tyre qe nuk eshte future ne kapitalin e kesaj shoqerie.

Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

## NENI 5

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria mediatike “DARDANI” shpk do te kete si objekt:

Veprimtaria radiotelevizive (lokale) perfshi prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikim

nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.

Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte te organizoje, regjistroje spektakle te bukurise, spektakle te modeleve, prodhimin e dokumentareve televiziv, filmave televiziv. Ka te drejte shitjen dhe tregtimin e pasurive te saj te prodhimeve audio dhe vidio si dhe prodhimeve te te tjereve kur eshte i autorizuar.

Shoqeria mediatike "DARDANI" shpk ka te drejte importimin e pajisjeve teknike qe i sherbejne prodhimit dhe transmetimit te figures dhe zerit si dhe tregtimin e tyre.

## KREU II

## MARREDHENIET EKONOMIKO- FINANCIARE

## NENI 6

## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqerise mediatike "DARDANI" shpk perbehet ne te holla ne nje vlere prej 500.000

Ky kapital themelor zoterohet nga ortaket ne kete menyre:

**1 . Isa Kreka zoteron 60% te kapitalit themeltar.**

**2 . Bashkim Kreka zoteron 40% te kapitalit themeltar.**

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transformueshme si ndermjet ortakeve ashtu edhe perkundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit ose pjeseve te tij ndermjet ortakeve ose ne favor te nje personi te trete behet gjithmone me miratim unanim te te gjithe ortakeve dhe me akt noterial. Ne rast te mos renies dakort nga ortaket, ne qoftese njeri nga ortaket deshiron te shese pjesen e kapitalit te tij ne natyre, duhet te respektoje te drejten e parablerjes nga ortaket e tjere, atehere shitja e kapitalit mund ti kalohet vetem ortakut tjeter ose nje personi tjeter te familjes dhe askujt tjeter jashte familjes. Nese njeri nga ortaket heq dore

vullnetarisht do te marri vetem pjese takuese te kapitalit te investuar plus fitimit te realizuar ( kjo e vertetuar me bilanc )

Te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar behen me miratimin e te gjithe ortakeve .
Vleresimi i kapitalit themeltar ne natyre behet nga ortaket ne nje marreveshje te vecante ose nga nje ekspert kontabel i caktuar nga ortaket.

## NENI 7

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar ne teresi ose vecanti, per nje ose disa ortake behet me vendim unanim te te gjithe ortakeve.
Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje regjister te vecante.

## NENI 8

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e tyre takuese ne kapitalin themelor.

## NENI 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdive ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje brenda muajit mars te vitit pasardhes. Bilanci i aktivitetit financiar mund te behet nga vete ortaket ose nga eksperte te caktuar prej tyre. Por ne te gjitha rastet rezultatet e bilancit financiar duhet te behen te njohura cdo ortaku dhe gjithmone rezultati perfundimtar duhet te merret ne shqyrtim nga asambleja e ortakeve, brenda 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

## NENI 10

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj, ne perputhje me rregullat ne fuqi. Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre , caktohen nga asambleja e ortakeve.

## NENI 11

Shoqeria i disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

# KREU III

# TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

## NENI 12

Ortaket kane te drejta te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve:

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare te shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin, si dhe ne perputhje me ligjet ne fuqi qe rregullojne veprimtarine mediatike.
- Te kerkojne dhe te marrin te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te disponojne te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (bilanci, libra llogarie, gjendja financiare, nevojat e shoqerise etj.).
- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe asamblese se Shoqerise.
- Te heqin dore nga shoqeria me kushtet qe percaktohen ne kontrate dhe ne kete statut.

## NENI 13

Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Te depozitojne kuotat e tyre ose kuoten suplementare ne perputhje me kontraten dhe me vendimet e Asamblese.
- Te marrin pjese ne administrimin e e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ata vete.
- Te kryejne detyrimet e ngarkuara nga Asambleja ose Administratori per realizimin e detyrave te shoqerise.

# KREU IV

## ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV SHOQERISE

### NENI 14

**Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.**

Ne asamble marrin pjese te gjithe ortaket me te drejte vote sipas shumave te vena ne kapitalin themelor te shoqerise.

Asambleja e ortakeve vendos per keto probleme:

- Miraton bilancin vjetor te shoqerise .
- Vendos per shtimin, pakesimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emeron dhe shkarkon administratorin e shoqerise.
- Ben modifikimet e nevojshme ne kontrat dhe statut sipas ecurive te shoqerise.
- Vendos per mbylljen e aktivitetit te shoqerise ose shnderrimin e shoqerise.

### NENI 15

Administratori i shoqerise ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredheniet me personat e trete.

Administratori nuk mund te kryej vetem ato detyra qe i jane lene per kopetence Asamblese ose ortakeve.

Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit.

## NENI 16

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete, kur gjate veprimeve te tyre shkelin ligjin, kontraten dhe statutin, ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

## NENI 17

Marredheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise mediatike "DARDANI" shpk, rregullohen me kontrata individuale, qe do te lidhen me secilin prej tyre.

# KREU V

## MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

## NENI 18

Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate ne qoftese ortaket me vullnetine e tyre te lire nuk e zgjatin kete afat.Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne kontrate kur per kete marrin vendim te gjithe ortaket. Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaket vendosin shnderrimin e shoqerise nga SHPK ne nje lloj shoqerie tjeter.

## NENI 19

Kur shoqeria likujdohet plotesisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit i cili paraqet bilancin e likujdimit. Pasuria e shoqerise, pasi shlyhen detyrimet qe ka shoqeria ndaj shtetit dhe te treteve, ju ndahen ortakeve ne proporcion me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejte shfrytezimi ju kthehet pronareve te saj.

## NENI 20

Shoqeria do te kete llogarite rrjedhese ne bankat e Shqiperise dhe jashte saj, do te kete vulen dhe stemen e saj.

## ORTAKET

**ISA KREKA**

Isa Kreka

**BASHKIM KREKA**

Bashkim Kreka

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**NOTERIA TIRANE**
**NR 1579 Rep**
**NR 314 Kol**

**VERTETIM**

Sot me date 14.12.2005 (dymije e pese) ne zyren e noterise ne Tirane me adrese rruga "Puntoret e Rilindjes" para meje noter Asim Zeka u paraqiten personalisht kerkuesit:

1- Isa Kreka I biri I Qazimit, lindur me date 05.06.1951 ne Gjakove, Kosove dhe banues ne Elbasan, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr. 1601364.
2- Bashkim Kreka, I biri I Qazimit, lindur me date 29.07.1971 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaport nr. Z1441676.

Te siperpermendurit me deklaruan se Statutin e mesiperm e kane bere me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe e nenshkruan para meje noterit Asim Zeka dhe une e vertetoj sipas ligjit.

**Noteri**
**Asim Zeka**

Banka Popullore

**Dega ELBASAN**
**Nr.Prot. 0071**

**Elbasan më:06/01/2006**

## KONFIRMIM BANKAR

Ju konfirmojmë se SHOQERIA MEDIATIKE DARDANI SH.P.K. ne krijim ka depozituar prane **BANKËS POPULLORE** Sh.A ELBASAN shumen prej 4,500 EURO (ekuivalentja ne LEKE 553,050 ), si kapital themelues te shoqerise per regjistrimin si person juridik ne Gjykaten e rrethit Gjygjsor Tirane.

Aleksandër ÇOHO

Drejtor i Degës

BANKA POPULLORE
DEGA ELBASAN

Banka Popullore Sh.a. ; KIB: 213 ; Kodi Fiskal: 3709533
Nr.Liçensës : 17, Dt.16.02.2004 ; NIPT : K4 142480 1U
Adresa : Rr."Donika Kastrioti" Nr11/1 Tiranë , SHQIPERI
SWIFT Code : PUPPALTR ; Tel : +355 4 2 72790/91
http://www.bpopullore.com ; Fax : +355 4 272781
E-mail:info@bpopullore.com; Mob:+35568(69)2060974

**Banka Popullore** Dega ELBASAN KIB21331011

| | | |
|---|---|---|
| Data:06.01.06 | Derdhje CASH | NR.vepr: 588862 |

Perfituesi: SHOQERIA MEDIATIKE DARDANI SH.P.K. Dt.Valuta:06.01.06 Shuma:

4,500.00/EUR

Llogaria Nr: 00021815/EUR

Pershkrimi: Derdhje CASH
KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE MEDIATIKE "DARDANI"SH.P.K. NE KRIJIM (KREKA, ISA)

ARK1805
Krisetda Poda

BANKA POPULLORE
DEGA ELBASAN
06.01.2006
A 1RK

VULA DHE NENSHKRIMI I BANKES
STAMP AND SIGNATURE OF THE BANK

Isa Kreka

NENSHKRIMI I KLIENTIT
CUSTOMER SIGNATURE

Shenim: Banka nuk mban pergjegjesi per gabimet qe rrjedhin nga instruksionet e pasakta te udhezuesit

Banka Popullore
Rr. Donika Kastrioti
1101 Tirane

Categoria : 7
Numero Conto : 00021815
Divisa : 3 EUR

SHOQERIA MEDIATIKE DARDANI SH.
L.QEMAL STAFA RR.11 NENTORI
8109 ELBASAN

| DATA | DESCRIZIONE OPERAZIONE | VALUTA | DARE AVERE | SALDO |
|---|---|---|---|---|
| 05-01-06 | SALDO PRECEDENTE | 05-01-06 | 0.00 | 0.00 |
| 06-01-06 | Derdhje CASH KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE MEDIATIKE "DARDANI"SH.P.K. NE KRIJIM (KREKA ISA) | 06-01-06 | 4,500.00 | 4,500.00 |
| | SALDO AL 06-01-2006 | | 4,500.00 | |

BANKA POPULLORE
DEGA ELBASAN
06.01.2006
A - 181

34746

# KERKESE

...uesit: 1. ***Isa Kreka i biri Qazimit, i datelindjes 05.06.1951, lindur ne*** ***...e, Kosove dhe banues ne Elbasan, rruga 11 Nentori, lagjia “Luigj*** ***...kuqi”, madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte*** ***...01364.***

***2. Bashkim Kreka i biri i Qazimit, i datelindjes 29.07.1971, lindur dhe*** ***...s ne Elbasan, rruga “11 Nentori”, lagjia “Luigj Gurakuqi”, madhor,*** ***...esi te plote juridike, me pasaporte nr.Z1441676.***

**...ti :** 1.Kerkojme regjistrimin ne regjistrin tregtare te shoqerise ...ike “DARDANI” shpk si person juridik.

**...igjore:** Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare”, Ligji ...7 date 28.01.1993 “ Per regjistrimin e shoqerive tregtare” dhe ligji ...0 date 30.09.1998: ”Per Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat ne ...iken e Shqiperise”.

## Gjykates se Rrethit Gjyqesor

## Tirane

...kuesit Isa dhe Bashkim Kreka kerkojme te regjistrojme si person juridik ...ne Mediatike “DARDANI” shpk me objekt te veprimtarise se saj: ...taria radiotelevizive (lokale) perfshi prodhimin, transmetimin dhe ...netimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, ... sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikim nepermjet ...elektromagnjenike, kabllove, perseritesave, sateliteve apo me cdo mjet

...a me pergjegjesi te kufizuar “DARDANI” shpk ne objektin e saj te kete ...en e organizimit dhe regjistrimit te spektakleve te bukurise dhe ...leve te tjera, prodhimin e dokumentareve televiziv etj. Te kete te drejten ...timit te paisjeve teknike qe sherbejne per prodhimin dhe transmetimin e ... dhe zerit.

...e shoqerise eshte ne qytetitn e Elbasanit.

...jatja e shoqerise eshte mbi 20 vjet.

... themelues i shoqerise eshte 500 000 (peseqindmijeleke).

...stratori i shoqerise eshte z. Isa Kreka.

Kerkuesit

| | |
|---|---|
| Isa Kreka | Bashkim Kreka |

...9.01.2006

**SHOQERIA TREGTARE**
**"KREKA" SHPK**
**ELBASAN**

# VENDIM

***I Asamblese se Ortakeve Nr. 15 date 02.12.2005***

Asambleja e Ortakeve te "KREKA" shpk e mbledhur sot me date 02.12.2005 me pjesemarrjen e plote te ortakeve vendosi:
Nga objekti i veprimtarise se shoqerise "KREKA" shpk te ndahet veprimtaria Radiotelevizive dhe te krijohet shoqeria mediatike "DARDANI" shpk si vazhdim i veprimtarise se TV DARDAN me eskluzivitet vetem objektin e veprimtarise radiotelevizive.
Autorizohet Administratori i shoqerise "KREKA"z. Isa Kreka te krijoje shoqerine e re mediatike "DARDANI" shpk me trashegimi lisencen, frekuencat dhe paisjet qe ka patur TV Dardan ne kuader te shoqerise "KREKA" shpk . Z. Isa Kreka shoqerine e re mund ta krijoje si ortak i vetem ose me ortake te tjere .Gjithashtu z. Isa Kreka autorizohet per te kryer ndryshimet e nevojshme edhe prane KKRT-se.
Kapitali i shoqerise "KREKA" nuk ndryshon.
Ky vendim merret ne zbatim te ligjit Nr. 8410 date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise" , ne te cilin kushtimisht kerkohet qe objekti i veprimtarise se shoqerive mediatike te jete vetem media dhe asnje veprimtari tjeter.
Ne kete mbledhje Ortaket vendosen qe nga statuti I shoqerise "KREKA" shpk te hiqet neni nr. 28 i cili flet per veprimtarine radiotelevizive dhe qe i eshte shtuar shoqerise " Kreka " me date 01.04.2001.
Mbasi te merret vendimi perkates ne Gjykaten e eTiranes te behet ndryshimi ne Regjistrin Tregtar.

**Ortaket**

| **Isa Kreka** | **Arber Kreka** |
|---|---|